



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 505/16 prot.,

Datë 26.03.2026

V E N D I M
Nr. 427/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 299/2026, datë 24.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-75737-02-10-2026 me objekt: “Blerje veshje, paisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale dhe shërbime”, me fond limit 3,860,400.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Assanet” sh.p.k, me NIPT L41817014E dhe me adresë: Rruga “Nënë Tereza”, Pallati ngjit me Renerin, Tirannë

Autoriteti Kontraktor: Albanian Gas Service Company Sh.a,
Rruga “Kosovarëve”, pallati: NdërPro, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 24.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 299/2026, ku vendosi:
[...]

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Assanet” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-75737-02-10-2026 me objekt: “Blerje veshje, paisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale dhe shërbime”, me fond limit 3,860,400.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Assanet” sh.p.k.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.. [...]”

I.3. Me shkresën nr. 19/11 prot., datë 09.03.2026, protokolluar me tonën nr. 505/13 prot., datë 11.03.2026, me objekt “ Kërkesë për zgjidhjen e problematikës lidhur me mënyrën e procedimit të mëtejshëm të procedurës së prokurimit me Nr. REF-75737-02-10-2026” autoriteti kontraktor Albanian Gas Service Company Sh.a, informon se e ka zbatuar vendimin Nr. 299/2026, datë 24.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke e ndarë në lote sipas konstatimeve të këtij vendimi por është në pamundësi për t’i ngarkuar për shkak se së pari kjo procedurë duhet të anulohet.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 19/119 prot., datë 09.03.2026, protokolluar me tonën nr. 505/37 prot., datë 11.03.2026, me objekt “ Kërkesë për zgjidhjen e problematikës lidhur me mënyrën e procedimit të mëtejshëm të procedurës së prokurimit me Nr. REF-75737-02-10-2026” autoriteti kontraktor Albanian Gas Service Company Sh.a, informon se e ka zbatuar vendimin Nr. 299/2026, datë 24.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke e ndarë në lote sipas konstatimeve të këtij vendimi por është në pamundësi për t’i ngarkuar për shkak se, së pari kjo procedurë duhet të anulohet.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Albanian Gas Service Company Sh.a nuk e ka zbatuar vendimin Nr. 299/2026, datë 24.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-75737-02-10-2026 me objekt: “Blerje veshje, paisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale dhe shërbime”, me fond limit 3,860,400.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a, Referuar shkresës së mësipërme Komisioni vlerëson se në kushtet e krijuara nga autoriteti kontraktor mbi procedurën e prokurimit si dhe ku shpreh se do të zbatojë vendimin, Komisioni vlerëson se në procedurën e re, që do të rishpallë, autoriteti kontraktor të pasqyrojë të gjitha modifikimet e konstatuara në vendimin nr. 299/2026, datë 24.02.2026 tw Komisionit tw Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

VENDOS:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-75737-02-10-2026 me objekt: “Blerje veshje, paisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale dhe shërbime”, me fond limit 3,860,400.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.

2. Autoriteti kontraktor me rihedhjen e procedurës së prokurimit të pasqyrojë ndryshimet në zbatim të vendimit të KPP-së të gjitha ndryshimet në dokumentat e procedurës që do të rishpallë, ku të jenë pasqyruara ndryshimet sipas vendimit 299/2026 datë 24.02.2026 të KPP-së
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

